



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 657/₃ Prot

Tiranë, më 30/6/2020

VENDIM

Nr. 19, datë 30.6.2020

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, shoqëria Integrated Security Solutions Sh.p.k, përfaqësuar nga z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 657 Prot., datë 09.06.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik shoqërisë “ILLYRIAN GUARD” Sh.a” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës së datës 12.05.2020, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni i disponuar nga Autoriteti Publik si më poshtë:

- 1- *Procesverbal për hartimin e kriterëve të kualifikimit të procedurës me nr. REF-56513-04-21-2020;*
- 2- *Procesverbal për hartimin e specifikimeve teknike të procedurës me nr. REF-56513-04-21-2020;*
- 3- *Sugjerimet e APP (nëse ka patur), në lidhje me DST, të procedurës me nr. REF-56513-04-21-2020;*
- 4- *Ankesat dhe kërkesat për sqarim të paraqitura nga Operatorët Ekonomik dhe përgjigjet e AK për procedurën me nr. REF-56513-04-21-2020;*
- 5- *Praktikën e AK për shqyrtimin e ankesave, përfshirë emërimin e anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave dhe Formularët e Përshkrimit të Punës, për secilin prej tyre;*

6- *Kopje të "Urdhrit për ngritjen e njësisë përgjegjëse, në zbatim të nenit 10 pika 1 e ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" dhe nëse ka pasur sinjalizim të brendshëm për këtë procedure?*

Referuar informacionit të paraqitur nga ankuesi, si dhe provave të administruara në dosje, nuk rezulton që Autoriteti Publik të këtë kthyer përgjigje në lidhje me kërkesat e listuara më sipër.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Zyra e Komisionerit, nëpërmjet shkresës nr. 657/1 Prot., datë 15.06.2020, ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Autoriteti Publik nëpërmjet shkresës nr. 1155/4 Prot., datë 18.06.2020, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 657/2 Prot., datë 22.06.2020, ka sqaruar ndër të tjerat se:

"...Procedurës me nr. Ref-56513-04-21-2020, nuk i ka mbaruar afati i dorëzimit të ofertave, por qëndron e pezulluar në sistemin on-line të Agjencisë së Prokurimit Publik, me urdhër pezullimi nr. 450, datë 28.04.2020. Dokumentet që kërkon operatori nuk mund të vihen në dispozicion, pasi kjo është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", konkretisht neni 21 "E drejta për informim" në të cilin parashikohet se: "Informacioni i administruar, sipas nenit 12 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës". Në datë 15.05.2020, Shoqëria Illyrian Guard Sh.a është njohur me vendimin nr. 209/1 Prot., datë 14.05.2020 të Komisionit të Prokurimit Publik, me objekt: "Urdhër për pezullimin e procedurës së prokurimit" dhe "Shqyrtimin e saj në themel", në këto kushte në rolin e Autoritetit Kontraktor ende nuk kemi dijeni si të vijojë kjo procedurë prokurimi pasi KPP nuk është shprehur me vendim...".

Në vijim, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", në të cilin parashikohet se "*...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", bazuar dhe në nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore ndërmjet palëve.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 30.06.2020, në prani të znj. _____, përfaqësuese e ankuesit nëpërmjet autorizimit nr. 10/3 Prot., date 30.06.2020 dhe znj. _____, përfaqësuese e Autoritetit Publik, nëpërmjet autorizimit nr. 192 Prot., datë 30.06.2020.

Gjatë seancës dëgjimore, Autoriteti Publik mbajti të njëjtin qëndrim të parashtruar në shkresën nr. 1155/4 Prot., datë 18.06.2020, lidhur me dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Mbasi u njoh me qëndrimin e Autoritetit Publik, pasi shkresa nr. 1155/4 Prot., datë 18.06.2020 e Autoritetit Publik nuk i ishte vënë në dispozicion nga ana këtij të fundit, Ankuesi e konsideroi arsyetimin e Autoritetit Publik për mosdhënien e informacionit të pambështetur në ligj.

Në vijim, bazuar në diskutimet e palëve gjatë seancës dëgjimore, Autoritetit Publik, në përputhje me pikën 3 të nenit 78 të Kodit të Procedurave Administrative, iu kërkua të paraqesë deklaratën përfundimtare në lidhje me të gjithë kërkesat e parashtruara nga Ankuesi.

Pas zhvillimit të seancës dëgjimore, nëpërmjet e-mailit të datës 30.06.2020, Autoriteti Publik informoi Zyrën e Komisionerit, *se nuk mund të vendosë në dispozicion informacionin/dokumentacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit me nr. REF-56513-04-21-2020, duke parashtruar të njëjtat argumente të cituar në shkresën kthim përgjigje për kërkesin.*

Ndërsa, në lidhje me kërkesën për kopje të “Urdhrit për ngritjen e njësisë përgjegjëse, në zbatim të nenit 10 pika 1 e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Autoriteti Publik sqaroi se: “nuk disponon një urdhër për “Ngritjen e njësisë përgjegjëse” në zbatim të pikës 1 të nenit 10, të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve””.

Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të administruar, Zyra e Komisionerit, konstaton se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar në parim përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” sipas të cilit: “*informacion publik është çdo e dhënë me ligj, akt nënligjor ose çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*”.

Pavarësisht sa më sipër, Komisioneri çmon se rasti konkret duhet trajtuar duke mbajtur në konsideratë gjithashtu dhe *lex specialis* në fushën e prokurimeve publike.

Konkretisht, ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 12 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikon se:

- 1. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.*
- 2. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë*

kontrollin e zbatimit të ligjit. Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën, këto të dhëna:

- a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;
- b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar;
- c) një përmbledhje të të gjitha kërkesave për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe një përmbledhje të të gjitha korigjimeve të bëra në këto dokumente;
- ç) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta, emrin dhe adresën e ofertuesit, nëse ka një të tillë, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, si dhe vlerën e kontratës;
- d) mënyrën e kualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve apo të mungesës së tyre;
- dh) vlerën ose mënyrën e përlogaritjes së vlerës dhe një përmbledhje të kushteve të tjera thelbësore për çdo ofertë dhe kontratë prokurimi;
- e) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave;
- ë) në rast të refuzimit të të gjitha ofertave, sipas nenit 24 të këtij ligji, deklaratën dhe arsyet e këtij refuzimi;
- f) për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji;
- g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre.

3. Autoriteti kontraktor administron për të gjitha procesverbalet për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit.

3/1. Në rastin e prokurimit elektronik, raporti i realizuar nga vetë sistemi, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit me mjete elektronike, bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.

Ndërkohë, neni 21, i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, parashikon se:

1. Informacioni i administruar, sipas nenit 12 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

2. Autoriteti kontraktor vë në dijeni jo më vonë se 5 ditë nga marrja e vendimit:

- a) çdo kandidat të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të pjesëmarrjes së tij në tender;
- b) çdo ofertues të pasuksesshëm, për arsyet e refuzimit të ofertës së tij;
- c) çdo ofertues të suksesshëm, që ka paraqitur një ofertë të vlefshme, për klasifikimin e ofertave së përzgjedhur.

3. Pa cënuar detyrimet që rrjedhin nga ky nen, autoritetet kontraktore mund të mos bëjnë publike disa nga informacionet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni, nëse një gjë e tillë vjen në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave ose cenon interesin publik apo interesat ligjorë dhe ekonomikë të palëve, ose pengon konkurrencën e drejtë.

Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar nga ana e Ankuesit, për sa i përket procedurës së prokurimit me nr. REF-56513-04-21-2020, përfshihet në nenin 12 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe në kushtet kur me vendimin nr. 209/1 Prot., datë 14.05.2020 të Komisionit të Prokurimit Publik, me objekt: "Urdhër për pezullimin e procedurës së prokurimit" dhe "Shqyrtimin e saj në themel",

kjo procedurë prokurimi është pezulluar, përpara përfundimit të fazës së klasifikimit të ofertave sipas kushtit të përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji, argumenti i dhënë nga Autoriteti Publik është i drejtë.

Në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ligji i aplikueshëm për rastin konkret, Ankuesi mund të kërkojë informacionin/dokumentacionin e listuar në kërkesën e tij, me përmbushjen e kriterit të përcaktuar për përfundimin e procesit të klasifikimit të ofertave.

Sa më sipër, vjen në përputhje dhe me pikën dy të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sipas të cilit *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”*.

Në përputhje qëllimin e Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit publikut duhet ti garantohet njohja me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktik, si dhe për ti shërbyer nxitjes së integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike, Zyra e Komisionerit, rekomandon Autoritetin Publik të vendosë në dispozicion të ankuesit, dokumentacionin sipas kërkesës datë 12.05.2020, menjëherë pas përfundimit të klasifikimit të ofertave për këtë objekt prokurimi, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Përsa i përket kërkesës së Ankuesit për *“Kopje të “Urdhrit për ngritjen e njësisë përgjegjëse, në zbatim të nenit 10 pika 1 e ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, për të cilën Autoriteti Publik nëpërmjet e-mailit të datës 30.06.2020 sqaroi se: *“nuk disponon një urdhr për “Ngritjen e njësisë përgjegjëse”*, Zyra e Komisionerit, vlerëson se nuk gjejnë zbatimin dispozitat e ligjit për të drejtën e informimit, për sa kohë Autoriteti Publik nuk disponon një dokumentacion/informacion të tillë, pavarësisht detyrimit ligjor që mund të kenë autoritetet publike në kuadër të legjislacionit të posaçëm.

Pavarësisht sa më sipër, Zyra e Komisionerit, sjell në vëmendje të Autoritetit Publik detyrimin sipas pikës 4 të nenit 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, për trajtimin e kërkesave për informim brenda afateve të përcaktuara, pavarësisht pengesave apo problematikave që mund të legjitimojnë mosdhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, pasi në të kundërt veprimi në kundërshtim me këtë parashikim, do të konsiderohet refuzim dhe do të trajtohet në përputhje me nenin 18 të këtij ligji.

Theksojmë në çdo rast se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Nga sa më sipër parashtruar, Komisioneri vlerëson se ankesa e paraqitur nga shoqëria Integrated Security Solutions Sh.P.K, ndaj Autoritetit Publik "ILLYRIAN GUARD" Sh.a, është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 859 Prot., datë 31.05.2019 të Integrated Security Solutions Sh.p.k, përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik "ILLYRIAN GUARD" Sh.a, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
3. Ky vendim u shpall sot në datë 30.6,2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

